

## **AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS**

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi autoritetin bankar dhe të pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 55 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

### **Rregulli 26 mbi Kontrollin e Mbrendshëm**

#### **Neni 1**

##### **1. Shtrirja e Rregullit**

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuar nga BPK-ja.

##### **2. Autoriteti Ligjor**

Ky rregull implementon nenin 55, të kapitullit VIII të rregullores së sigurimeve.

##### **3. Definicionet**

“Bordi i drejtorëve” nënkupton renditjen më të lartë të trupit qeverisës të një korporate, të përbërë nga anëtarët e zgjedhur nga aksionarët me të drejtë vote. Në këtë rregull termi “bordi i drejtorëve” i referohet:

- a) Në rast se një korporate apo kompani e krijuar dhe që ekziston nën ligjet e Kosovës, bordi i drejtorëve e organizon vetën.
- b) Në rast të një kompanie të huaj të inkuorporuar në juridiksion tjetër, por e cila është licensuar që të ushtroj biznesin e sigurimeve në Kosovë, zyrtari i lartë i kompanisë në Kosovë, i cili është banor i Kosovës dhe i pranuar si i till nga BPK-ja.

“Bordi” i referohet bordit të drejtorëve siç është definuar në këtë rregull.

“Kontrolla e mbrendshme” apo “ sistemi i kontrollës së mbrendshme” i referohen politikave të shkruara në formë të dokumentit, procedurave dhe praktikave të miratuara dhe të zbatuara në dizajnin e kompanisë për t’i mbrojtur mjetet e veta nga zbulimi i paligjshëm i humbjeve dhe abuzimi dhe për të siguruar udhëheqje profitabile të biznesit.

“Kompania e licensuar” apo “ Kompania” i referohet njëres apo të dyjave, kompanisë së sigurimit dhe ndërmjetësuesit të sigurimit.

“Zyrtari i lartë” është zyrtari më i lartë i një kompanie të licensuar, pamarrparasysh se a e ka titullin e “Kryetarit”, “Nenkryetarit”, “Drejtorit Menaxhues”, “perfaqesuesit të shtetit”, “Menaxherit”, apo ndoj titull tjetër të tillë.

## **Neni 2**

### **Miratimi i Sistemit Adekuat dhe Efektiv të Kontrollës së Mbrendshme**

#### **1. Përgjegjësia e Bordit**

Udhëheqja e biznesit të sigurimit përfshinë aplikimin e sistemit të kontrollit të mbrendshëm. Menaxhmenti i kompanisë duhet t’i formuloj standardet e politikës operative, procedurave dhe praktikave të cilat duhet të miratohen dhe të zbatohen nga kompania në udhëheqjen e biznesit të saj. Është përgjegjësi e bordit të kaloj dhe të përshkruaj një sistem adekuat dhe efektiv të kontrollit të mbrendshëm në kompani.

#### **2. Kërkesat për një Sistem Efektiv të Kontrollit të Mbrendshëm**

Politikat e shkruara standarde, procedurat dhe praktikat në kompani, duhet të jenë fleksibile dhe të lejojnë korrektime dhe të redaktohen sipas nevojave, të jep mundësi kompromisi në sistemin e kontrollit të mbrendshëm të kompanisë. Ky sistem duhet të jetë adekuat dhe efektiv në lidhje me organizimin struktural, natyrën dhe shkallën e biznesit të kompanisë. Në minimum, sistemi i kontrollit të mbrendshëm duhet t’i plotësoj direktivat me sa vijon:

- a) Asnjë individ në organizatë nuk duhet të ketë fuqi të lirë dhe absolute në vendimmarrje.
- b) Asnjë individ nuk duhet të ketë kontrollin e lirë dhe absolut të transaksioneve. Kontrolli i keshit (parave të gatshme) dhe mjeteve tjera duhet të ketë së paku dy nënshkrime të individëve përgjegjës të cilët janë subjekt i përgjegjësisë.
- c) Eksperti i sigurimeve (aktuari) dhe revizori i jashtëm nuk duhet të jenë zyrtarë apo të punësuar të kompanisë apo një nga anëtarët apo vartësit e saj, për të siguruar së llogaritjet e dispozitave teknike dhe përgjegjësiive tjera janë adekuate dhe për të siguruar konservatizëm në vlerësimin e mjeteve të kompanisë dhe në përcaktimin e fitimeve apo humbjeve. Aktuari dhe revizori i jashtëm i raportojn drejtëpërdrejt bordit.
- d) Transaksionet me palët e afërta janë të ndaluara përveq nëse lejohen nga BPK-ja në pajtim me rregulloren e sigurimeve dhe në pajtim me rregullin 27.
- e) Krijimi, funksionimi dhe organizimi i revizorit të mbrendshëm është nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e bordit. Revizori i mbrendshëm duhet të ketë qasje në të gjitha vijat dhe departamentet përkatëse të kompanisë, duhet të ketë staf të mjaftueshëm me personel të trajnuar dhe experiencë përkatëse.
- f) Pranimi i riskut duhet të jetë në pajtim me direktivat e nënshkruara të përshkruara nga bordi. Direktivat duhet të përfshijnë përcaktimin e mbetjes së riskut, të vetëm dhe në total, procedurat të cilat zbatohen në renditjen e riskut përtej direktivave të shkruara, lënja e riskut për të risiguruarit dhe pranimin e riskut të risigurimit.
- g) Mjetet investuese të kompanisë duhet të jenë në pajtim me politikat dhe direktivat e përshkruara nga bordi në pajtim me rregullin 12, pjesa II apo siç janë përshkruar nga direktivat e shkruara të BPK-së.
- h) Përcjellja e definuar e standardeve të tregut, mbi trajtimin e drejtë të klientëve, zbulimin adekuat ndaj klientëve në benefitin e policës, riskun dhe përgjegjësitë, trajtimi i parave të klientit, ndarja e principeve dhe aktivitetit të agjentit dhe konfliktit të interesave.
- i) Administrimi me kohë dhe i përshtatshëm i funksioneve kontabiliste për të siguruar pajtueshmëri të llogarive, deri në ditën e shënimeve të llogarive, dhe produktivitetin e informatës së sakt dhe të besueshme për menxhmentin.

- j) Kontrollë të vazhdueshme fizike dhe përgjegjësi për të gjitha mjetet dhe investimet në kompani.
- k) Themelimi i procedurave për vërejtjen me kohë të transaksioneve jo të favorshme apo të dyshimta duke përfshirë zbatimin e sistemit adekuat të qekave dhe balancit.
- l) Themelimin e procedurave për t'i vërejtur menjëherë devijimet nga pajtueshmëria e rregullores.
- m) Themelimi i vijave të komunikimit mirë të definuar mbrenda organizatës nga punëtorët e nivelit më të ulët deri te menaxhmenti dhe deri te bordi me sistem kredibil përgjegjës.
- n) Themelimi i procedurave për të siguruar bordin me mbikëqyrje adekuate të aktiviteteve të përgjithshme, për të siguruar vërejtjen me kohë të kontrollit të mbrendshëm deficitar, devijimin dhe/apo transaksioneve të dyshimta.
- o) Edhe kërkesa të tjera siç mund të përshkruhen nga BPK-ja në pajtim me rregulloren e sigurimeve dhe këtyre rregullave.

### **Neni 3**

#### **Autoriteti i BPK-së për të Shqyrtuar dhe Plotësuar Kontrollin e Mbrendshëm**

##### **1. Shqyrtimi i Sistemit të Kontrollit të Mbrendshëm**

Bordi i drejtorëve i një kompanie të sigurimit duhet t'i jap qasje të plotë BPK-së në shqyrtimin e kompetencave dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të mbrendshëm të kompanisë. Revizori i mbrendshëm i raporton nëse kompania duhet në cdo kohë t'i jap qasje BPK-së sipas kërkesës së saj.

##### **2. Sistemi Plotësues i Kontrollit të Mbrendshëm**

Nëse BPK-ja e konsideron të nevojshme, pas kryerjes së shqyrtimit të sistemit të kontrollit të mbrendshëm, duhet ta drejtoj kompaninë të inkorporohet në sistemin e tyre të kontrollës së mbrendshme:

- a) Politika të tilla, procedura apo praktika të cilat janë të nevojshme për të forcuar kontrollin ekzistues, duke përshkruar fushat ku BPK-ja e përcakton se sistemi i tanishëm është deficitar dhe jep kontrollin e nevojshëm për të korrigjuar deficitin.

b) Nëse BPK-ja e përcakton se kompania e sigurimit apo ndërmjetësuesi i sigurimit ka dështuar në miratimin dhe instalimin e sistemit të kontrollës së mbrendshme, apo nëse qëllimi i sistemit të kontrollit të mbrendshëm nuk është i shkruar, BPK-ja mund ta suspendoj licensën e kompanisë deri në atë kohë kur kompania ta ketë miratuar dhe instaluar, me të shkruar, sistemin e vet të kontrollit të mbrendshëm.

#### **Neni 4** **Hyrja në fuqi**

Ky rregull, hyn në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman  
Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral